

SIGURIMI I PERGJEGJESISE PROFESIONALE - KUSHTET E PERGJITHSHME TE SIGURIMIT

Pasi I Siguruari i emertuar ne Formularin bashkangjitur i ka drejtuar shoqerise se sigurimeve **INTERSIG Vienna Insurance Group Sh.A.** (ketu e me poshte i quajtur "Siguruesi") nje kerkese me shkrim duke plotesuar nje Pyetesor i cili se bashku me cdo deklarim tjeter te bere me shkrim nga i Siguruari ne lidhje me kete Police konsiderohen te perfshira ne te,

atehere, kjo Police Sigurimi DESHMON se, me kusht qe i Siguruari t'i kete paguar Siguruesit primin(et) e permendur(a) ne Formular dhe ne baze te kushteve, perjashtimeve, parashikimeve dhe kufijve te permbajtura ne Police ose te shtuara ne te, Siguruesi do te demshperbleje te Siguararit deri ne/por pa e kaluar kufirin e pergjithshem te pergjegjesise te percaktuar ne Formular per shuma qe i Siguruari eshte pergjegjes per t'i paguar paleve te treta bazuar ne Kerkesa per Demshperblim per shkeljet e kryera pas Dates Prapavepruese te percaktuar ne Formular, qe paraqiten per here te pare ndaj te Siguararit brenda Periudhes se Sigurimit, si rrjedhoje e shkeljes nga ana e te Siguararit te detyres profesionale sipas llojit te veprimtarise te pershkruar e formularin e kesaj police.

1. Perkufizime

1.1. "**Kerkese per Demshperblim**" do te konsiderohet marrja nga Siguruesi e nje kerkese me shkrim nga i Siguruari per demshperblimin e nje pagese te kryer ose qe duhet te kryeje i Siguruari qe ka lidhje vetem me kryerjen e detyres profesionale sipas llojit te veprimtarise te pershkruar ne formularin e kesaj police.

Cdo kerkese per demshperblim duhet:

- i. Te behet per deme dhe me qellim marrjen e kompensimit, si edhe shpenzimet e mbrojtjes te miratuara paraprakisht nga Siguruesi;
- ii. Te jete ngritur kundrejt te Siguararit brenda afatit te polices se sigurimit;
- iii. Te behet per deme te mirefillta financiareqe rrjedhin nga veprim, gabim ose mosveprim si pasoje e neglizhences, te kryer nga i Siguruari gjate afatit te sigurimit;
- iv. Te kete ndodhur ne rrjedhen e permbushjes se zakonshme te sherbimeve profesionale nga i Siguruari;
- v. Te kete lidhje me veprim, gabim ose mosveprim si pasoje e neglizhences, qe fillimisht ka ndodhur ose mund te kete ndodhur pas dates prapavepruese te percaktuar ne Formularin e polices.

1.2. "**Shpenzime Mbrojtje**" do te konsiderohen shpenzimet e kryera nga Siguruesi, ose shpenzimet e arsyeshme te kryera nga i Siguruari me miratimin paraprak te Siguruesit, per investigimin, mbrojtjen, raportimin ose negocimin per zgjidhje te cdo kerkese per demshperblim.

1.3. **Dem Financiar** nenkupton:

Te gjitha ato pretendime per humbje te ngritura kundrejt te Siguararit dhe qe nuk klasifikohen as si deme trupore (vdekje, demtime te tjera fizike) dhe as si demtime materiale (demptim, shkaterrim ose humbje pasurie) si dhe qe nuk rrjedhin si pasoje e humbjeve te tilla.

1.4. **Kufiri i Pergjithshem i Pergjegjesise (Kufiri Agregat)** nenkupton:

Shumen totale maksimale te sigurimit (per deme financiare dhe te gjitha shpenzimet perkatese te mbrojtjes ligjore), qe mund te paguhet gjate periudhes se sigurimit, pavaresisht nese demet i perkasin nje apo disa humbjeve.

1.5. **I Siguruari** nenkupton:

- 1.5.1. Personi ose personat e emeruar si te tille ne formularin e polices,
- 1.5.2. Cdo person apo persona te cilet behen ortak te shoqerise se siguruar gjate periudhes se sigurimit te polices,
- 1.5.3. Cdo person te punesuar nga i Siguruari dhe te deklaruar ne pyetesorin e polices se sigurimit ose te deklaruar me shkrim nga i Siguruari gjate periudhes se mbulimit.

1.6. **Baza Ligjore:** Kodi Civil i Republikes se Shqiperise.

2. Kushtet

Kufiri i demshperblimit

- a) Vlera e pergjithshme e demshperblimit (qe perfshin shpenzimet e pales/ve te treta te demtuar) qe i Siguruari mund te perfitoje nga kjo police per te gjitha kerkesat e paleve te treta kunder te Siguruarit gjate periudhes se sigurimit, nuk do ta kaloje asnjehere kufirin e demshperblimit ne agregat (per te gjitha ngjarjet e ndodhura gjate periudhes se mbulimit) qe eshte percaktuar ne formularin e polices. Kufiri i demshperblimit nuk do te rritet edhe ne rast se ne formularin e polices caktohet me shume se nje i Siguar, ose nese padite apo kerkesat ngrihen nga me shume se nje person ose organizate.
- b) Siguruesi mund t'i paguaje te Siguruarit ne cdo kohe, per deme ndaj paleve te treta ose seri demesh, deri ne kufirin e percaktuar ne formularin e polices. Ne rast se Siguruesi do ta demshperbleje te Siguruarin per me teper se nje kerkese per demshperblim gjate periudhes se sigurimit, atehere shumat e paguara do te zbriten nga kufiri i percaktuar ne police. Ne qofte se i Siguruari do te kerkoje te rivendose kufirin fillestar te demshperblimit, atehere duhet te paguaje nje prim shtese te llogaritur nga Siguruesi.

3. Pjesa e zbritshme

Siguruesi eshte pergjegjes per ate pjese te cdo kerkese te paleve te treta te ngritur gjate periudhes se sigurimit qe tejkalon vleren e pjeses se zbritshme te percaktuar ne formularin e polices.

Pjesa e zbritshme vlen per cdo kerkese per demshperblim te pales se trete dhe nuk kufizohet nga ndonje shume totale.

4. Data prapavepruese

Kjo police sherben per demshperblimin e te gjitha atyre demeve te cilat ndodhin dhe zbulohen gjate periudhes se sigurimit si dhe te gjitha atyre demeve, te cilat raportohen gjate periudhes se sigurimit te polices dhe qe i takojne nje veprimi te gabuar te kryer pas dates prapavepruese te shenuar ne formularin e polices.

5. Perjashtime

Kjo police nuk demshperblen te Siguruarin per demet te cilat:

- 5.1. Jane me te vogla se pjesa e zbritshme;
- 5.2. Rrjedhin, bazohen apo i atribuohen nje veprimi te gabuar te kryer jashte fushes se objektit te te Siguruarit sipas percaktimit ne formularin e polices, dhe jashte territorit gjeografik te percaktuar ne kete formular;
- 5.3. Bazohen ne shpifje, pergojime ose ankesa te shkruara;
- 5.4. Rrjedhin, bazohen apo i atribuohen nje veprimi me dashje te punonjesit te te Siguruarit, perfshi ketu edhe cdo veprim ne mashtrim, keqbesim apo veper penale;
- 5.5. Rrjedhin nga humbja apo shkaterrimi i ndonje dokumenti (origjinal, riprodhim, ne cd) per shkak te veprimeve te Siguruesit ose punonjesve te tij apo cdo personi tjetër qe punon apo ka punuar per llogari te te Siguruarit;
- 5.6. Bazohen ne gjoba, ndeshkime dhe/ose deme tipike apo deme te tjera te ngjashme;
- 5.7. Shkaktohen ose vijne si pasoje e rasteve vijuese: luftes, pushtimit, veprimeve armiqesore te huaja, kryengritje, ose veprime te ngjashme me luften (te shpallura ose jo), luftes civile, grevave, kryengritjeve ushtarake, rebelimeve, revolucioneve, fuqive pushtuese ose ushtarake;
- 5.8. Humbjes ose shkaterrimit te, ose demtimit ne, cdo lloj pasurie, ose cdo humbje apo shpenzimi cfaredoqofte si rezultat ose rrjedhur prej tyre, ose demi vijues, ose cdo pergjegjesie ligjore te cfaredolloj natyre te shkaktuar direkt nga, kontribuar prej, ose rrjedhur nga:
 - 5.8.1. Rrezatimet jonizuese ose ndotja radioaktive prej karburantit berthamor ose prej derdhjeve berthamore nga shperthimi i karburantit berthamor;
 - 5.8.2. Vetite radioaktive, helmuese, eksplozive ose veti te tjera te demshme te cdo njesie shperthyese berthamore ose perberesi berthamor;
- 5.9. Mbeshteten ne garanci te shkruara (garanci kontrate e lidhur me palet e treta) leshuar ng i Siguruari apo punonjesit e tij ose cdo personi tjetër qe punon apo ka punuar per llogari te te Siguruarit;
- 5.10. Lidhen me falimentimit ose paaftesine paguese te te Siguruarit;
- 5.11. Lidhen me veprimtarine e te Siguruarit ose personave qe punojne per te, ne fusha te ndryshme nga ato te percaktuara ne formularin e Polices se sigurimit;
- 5.12. Rrjedhin nga veprimtaria dhe/ose statusi i te Siguruarit si nepunes ne administraten publike, nepunes i qeverise, ose si arbiter;

- 5.13. Rrjedhin nga marreveshje kontraktore apo marreveshje te tjera te vecanta qe tejkalojne objektin e pergjegjesise ligjore;
- 5.14. Prekin personalisht te Siguruarin ose te afermit e tij;
- 5.15. Rrjedhin nga keshilla financiare dhe/ose per investim ose keshilla mbi perfaqesimin apo parashikime te dhena nga personi i siguruar jashte objektit te kesaj kontrate;
- 5.16. Rrjedhin nga kryerja e veprimtarise se te Siguruarit jashte objektit normal te profesionit te drejtuesit ligjor te shoqerise sipas CKP;
- 5.17. Cdo veprim, gabim, ose keqperdorim i Informacionit konfidencial, i te drejtave te autorit, markave dhe logove qe mund te vije si pasoje e ushtrimit te Sherbimeve Profesionale.
- 5.18. Sulmet kibernetike dhe/ose pervetesimi dhe keqperdorimi i informacioneve konfidencial te marra nepermjet sulmeve kibernetike.
- 5.19. Pandemite , epidemite.

6. Trajtimi i kerkeses per demshperblim

- 6.1. Siguruesi do te trajtojte te gjitha kerkesat per demshperblim qe jane objekt i polices se sigurimit, lidhur me padite e ngritura ndaj te Siguruarit edhe nese ndonje nga pretendimet e padise eshte i pabazuar, i pavertete, apo ne mashtrim. Per keto raste pranohet se Siguruesi mund te kryejte nje hetim dhe se trajtimi i kerkeses per demshperblim apo padise do te bazohet ne te dhenat e nxjerra nga ky hetim.
- 6.2. Siguruesi nuk pergjigjet per asnje kerkese per demshperblim, vendim gjyqesor apo mbrojtje padie ne rast se e ka paguar shumen e percaktuar si kufiri agregat ne formularin e polices.
- 6.3. Siguruesi nuk mban pergjegjesi per mbulimin e shpenzimeve qe jane kryer nga *i Siguruari* pa marre miratimin paraprak te Siguruesit.
- 6.4. Siguruesi nuk trajton asnje kerkese per demshperblim pa pelqimin e te Siguruarit. Ne rast se i Siguruari nuk bie dakord me trajtimin e demit sipas rekomandimit te Siguruesit dhe vendos te kundershtojte kerkesen per demshperblim apo te vazhdoje procedurat ligjore ne lidhje me kete kerkese, atehere ne cdo rast pergjegjesia e Siguruesit per kerkesen ne fjale nuk e kalon shumen e kerkuar ne "*kerkesen per demshperblim*".

7. Momenti i kerkeses se paleve te treta dhe kushtet e njoftimeve

Per qellimet e kesaj police, kerkesa per demshperblim e ngritur nga nje pale e trete mendohet se eshte bere sapo i Siguruari dhe/ose nje nga perfaqesuesit e tij fillimisht:

- a) Marrin nje kerkese me shkrim per deme qe mbulohen nga kjo police sigurimi.
- b) Vjen ne dijeni mbi qellimin e ndonje personi te trete per berjen e nje kerkese te tille ndaj tyre.
- c) Vjen ne dijeni te cdo fakti, rrethane apo ngjarje qe mund te jape shkas per ngritjen e nje kerkese per demshperblim ne nje kohe te ardhme.
- d) I Siguruari ne rast te ndodhjes se nje demi i ben menjehere njoftim me shkrim Siguruesit me kushtin qe polica te jete ne fuqi.

Keto njoftime demesh behen ne adresen:

Ne vemendje te: **INTERSIG VIG Sh.A.**

Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower, Kati 2-të, Tiranë

Tel: +355 4 22 70 576

Faks: +355 4 22 70 577

e-mail: info@intersig.al

8. Detyrimet e te Siguruarit ne rastin e zbulimit te demit

Te Siguruarit i jepet demshperblimi sipas kesaj police kur ai ploteson keto kushte paraprake:

- a) Jep me shkrim te dhenat te mjaftueshme per njohjen e te Siguruarit si dhe informacion te plote mbi kohen, vendin dhe rrethanat e demit te zbuluar, emrat dhe adresat e te demtuarit dhe deshmitareve te mundshem. Keto te dhena duhet t'i behen te ditura Siguruesit ose perfaqesuesve te tij te autorizuar sa me shpejt te jete e mundur, por ne cdo rast brenda 48 oreve nga koha e ngritjes se kerkeses per demshperblim,
- b) I percjell menjehere Siguruesit cdo kerkese, njoftim apo procedim te marre prej tij ose perfaqesuesit, ne rastin e ngritjes se ndonje kerkese per demshperblim apo padie kunder tij. I Siguruari vete apo cdo person tjetër per llogari te tij nuk duhet te marre persiper asnje pergjegjesi dhe nuk duhet te beje asnje oferte, premtim apo pagese pa miratimin e shkruar te Siguruesit, i cili ka te drejte qe te marre persiper ne emer te te Siguruarit

- c) mbrojtjen apo trajtimin e cdo kerkese per demshperblim apo ndjekjen ne favor te te Siguararit si dhe ka liri te plote per ndjekjen e cdo personi dhe zgjidhjen e cdo kerkese te tille.
- d) Bashkepunon me Siguruesin dhe me kerkesen e tij te paraqese per shqyrtim dhe pyetje tek perfaqesuesi i Siguruesit, dokumentacionin e kerkuar dhe te marre pjese ne cdo seance degjimi, deshmi, hartim vleresimi, gjetje dhe dhenie provash, prani deshmitaresh dhe ndjekje padish, si dhe tu jape deklarata me shkrim apo me goje perfaqesuesve te Siguruesit dhe te zhvilloje takime me ta per qellimet e hetimit.
- e) Ushtron cdo te drejte kontraktore per kundershtrim dhe, ose kerkimin e arbitrazhit kundrejt cdo kerkese per demshperblim te ngritur kunder te Siguararit, sipas udhezimeve te Siguruesit.

9. Garanci

Deklaratat dhe te dhenat e shenuara ne Pyetesor, te permendura ne Formularin e Polices si dhe cdo informacion shtese ne lidhje me to, te dhena nga i Siguaruari apo per llogari te tij, garantohet se perbejne kriteret baze te kesaj police dhe jane pjese perberese e saj.

I Siguaruari nepermjet nenshkrimit te polices sesigurimit, bie dakord se:

- a) Deklaratat dhe te dhenat e Pyetesorit, si dhe cdo informacion tjeter shtese, jane te verteta dhe kjo police leshohet duke u bazuar ne vertetesine e tyre;
- b) Ne rast se keto deklarata dhe te dhenat e Pyetesorit ose ndonje informacion shtese, permban pavertesiti te cilat ne menyre thelbesore ndikojne ne pranimin e rrezikut nga Siguruesi, atehere polica ne teresi do te konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do te prodhoje asnje pasoje.

10. Kerkesat per deshperblime ne mashtrim apo te rreme

Nese i Siguaruari ben nje kerkese per demshperblim duke ditur se ajo vete eshte e rreme apo ne mashtrim persa i perket shumes ose vertetesise se ngjarjes, atehere polica ne teresi do te konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do te prodhoje asnje pasoje.

11. Juridiksioni

Kjo police mbulon ne sigurim vetem demet qe i Siguaruari mund te shkaktoje gjate kryerjes prej tij te sherbimeve sipas llojit te veprimtarise se pershkruar ne formularin e kesaj police brenda territorit te Republikes se Shqiperise, per te cilat eshte marre nje vendim perfundimtar nga nje trup gjykues kompetent, bazuar ne ligjin shqiptar.

12. Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Ne rast mosmarreveshjesh midis paleve, te cilat nuk arrijne te zgjidhen me mirekuptim, palet do t'i nenshtrohen juridiksionit te Gjykates kompetente Shqiptare konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

13. Ndryshime thelbesore

13.1. Ndryshime ne pronesine e shoqerise se te Siguararit

Ne rast se do te kete ndryshime ne pronesine e shoqerise se te Siguararit nepermjet shkrirjes, blerjes apo shitjes se asetave ose aksioneve apo cdo menyre tjeter, atehere i Siguaruari duhet te njoftoje me shkrim Siguruesin per keto ndryshime. Bazuar ne rendesine e ndryshimeve per vleresimin e rrezikut, Siguruesi mund te vendose te rishikoje kushtet e polices se sigurimit apo zgjidhjen e saj.

13.2. Rritja ose ulja e rrezikut

Nese gjate periudhes se sigurimit ndryshon nje fakt i rendesishem, i cili eshte deklaruar ne Pyetesor ose ne informacionin shtese te dhene nga i Siguaruari, ndryshim i cili ndikon ne menyre thelbesore ne vleresimin e rrezikut, atehere i Siguaruari duhet te njoftoje Siguruesin me shkrim, sa me shpejt qe te jete e mundur mbi kete ndryshim. Ne kete rast, Siguruesi mund te vendose te rishikoje kushtet e polices apo zgjidhjen e saj.

14. Primi i sigurimit

Primi i sigurimit eshte i shenuar ne Formularin e Polices dhe eshte i pagueshem brenda 15 diteve nga leshimi i polices se sigurimit, nese nuk eshte rene dakort ndryshe mes paleve.

Mosrespektimi i afateve te pageses se primit nga ana e te siguararit, interpretohet sipas KC.

15. Zgjidhja e kontrates se sigurimit

Kjo police mund te zgjidhet nga cdonjera prej paleve me ane te njoftimit me shkrim pales tjeter, ku do te tregohet data e zgjidhjes, gjithmone jo me pak se 30 (tridhete) dite pas dergimit te njoftimit. Ne rast se Siguruesi do te

zgjidhe kontraten per shkak te mos pageses se primit nga i Siguruari, atehere Siguruesi ka te drejte ta zgjidhe policen brenda 14 diteve nga njoftimi me shkrim qe i ka derguar te Siguararit.

Rregullimi i primit ne momentin e zgjidhjes se polices se sigurimit mund te behet me marreveshje midis paleve, ne perputhje me periudhen e mbetur te sigurimit.

Kjo police do te konsiderohet menjehere e zgjidhur me shterimin e shumes se percaktuar si kufiri agregat (i pergjithshem) ne formularin e polices, si pasoje e nje apo disa pagesave te bera sipas kesaj police. Ne rast se i Siguruari do te kerkoje vazhdimin e qendrimit ne fuqi te polices ose rritjen e kufirit te pergjegjesise, ai duhet te paguaje nje prim shtese sipas perllogaritjeve te Siguruesit.

16.Kalimi i te drejtave (subrogimi)

Ne rastin e kerkesave per demshperblim sipas kesaj police, Siguruesit do t'i kalohen te gjitha te drejtat per rimbursim/kompensim kundrejt nje personi apo organizate te trete. Siguruesi do te kete te drejten te ndjeke dhe kerkoje plotesimin e ketyre te drejtave ne emer te te Siguararit, i cili do t'i jape Siguruesit te gjitha ndihmen dhe bashkepunimin e nevojshem. I Siguruari nuk duhet te ndermarre asnje veprim qe paragjykon keto te drejta. Cdo shume e marre si rimbursim nga Siguruesi qe tejkalon shumen e pergjithshme te paguar nga Siguruesi do t'i kalohet te Siguararit duke zbritur shpenzimet e Siguruesit per perfitimin dhe marrjen e rimbursimit.

17.Masat paraprake per parandalimin e demit

I Siguruari ka detyrimin qe te ndreqe me shpenzimet e tij dhe brenda kohes se arsyeshme, cdo suate te demshme e cila mund te shkaktoje dem apo humbje ose eliminimi i se ciles kerkohet prej Siguruesit.

18.Sigurime te tjera

Ne rast se klienti ka lidhur te njeften police sigurimi me Sigurues te ndryshem, atehere kjo police do te sherbeje vetem per pagimin e demeve ne tejkalim te limiteve te demshperblimit te policave te tjera.

19.Transferimi i Polices

Polica e sigurimit konsiderohet e pavlefshme ne rast se do t'i kalohet apo caktohet ndonje personi tjetër pa miratimin paraprak te Siguruesit.

20.Konfidencialiteti

I Siguruari duhet te beje te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te mos zbuluar ekzistencen e kesaj police personave jokompetente, me perjashtim te keshilluesve/eksperteve profesionale ose sipas ligjit si dhe vendimit te gjyqit.

Klauzola e Sanksioneve:

“(Ri)Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë dëm apo të japë ndonjë përfitim të parashikuar në këtë kontratë, në atë masë që sigurimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një dëmi të tillë ose sigurimi i një përfitimi të tillë do ta ekspozojnë (ri)Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi sipas rezolutave të Kombeve të Bashkuara apo sanksioneve tregtare ose ekonomike, legjislacionit të Bashkimit Evropian, Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës (me kusht që kjo nuk bie në kundërshtim me ndonjë rregullore ose ligj lokal specifik të zbatueshëm për (ri)siguruesin).”

Përjashtimi i rrezikut kibernetik

Qasja ose zbulimi i informacionit konfidencial ose personal dhe përgjegjësisë që lidhet me të dhënat Dëmet që vijnë nga:

- 1) Çdo akses ose zbulim i informacionit konfidencial ose personal të çdo personi ose organizate, duke përfshirë patentat, sekretet tregtare, metodat e përpunimit, listën e klientëve, informacionin financiar, informacionin e kartës së kreditit, informacionin shëndetësor ose çdo lloj informacioni tjetër jopublik; ose
- 2) Humbja, humbja e përdorimit, dëmtimi, korrupsioni, pamundësia për të aksesuar ose pamundësia për të manipuluar të dhënat elektronike.

Ky përjashtim zbatohet edhe nëse pretendohen dëme për kostot e njoftimeve, shpenzimet e monitorimit të kredisë, shpenzimet mjeko-ligjore, shpenzimet e marrëdhënieve me publikun ose çdo humbje, kosto ose shpenzim tjetër të shkaktuar nga ju ose të tjerët që rrjedhin nga ajo që përshkruhet në Paragrafin 1) dhe 2) më sipër.

Megjithatë, nëse nuk zbatohet paragrafi 1) i mësipërm, ky përjashtim nuk zbatohet për dëmet për shkak të lëndimit trupor. Ky përjashtim nuk zbatohet as për dëmet pronësore. Çdo humbje. Dëmtimi. Fshirja, prishja e deformimit të të dhënave elektronike nuk do të konsiderohet si dëm pasuror.

Në kuptimin e këtij përjashtimi, të dhënat elektronike nënkuptojnë informacione, fakte ose programe të ruajtura si ose në, të krijuara ose të përdorura në, ose të transmetuara në ose nga programet kompjuterike, duke përfshirë softuerin e sistemeve dhe aplikacioneve, disqet e ngurtë ose floppy, CD-ROM, kaseta, disqe, qelizat, pajisjet e përpunimit të të dhënave ose çdo media tjetër që përdoret me pajisje të kontrolluara elektronikisht.

Përjashtimi i sëmundjeve ngjitëse

Kjo policë sigurimi nuk mbulon asnjë: humbje, dëmtim, përgjegjësi, kërkesë për dëmshpërblim, kosto ose shpenzim të çfarëdolloj natyre, të shkaktuar / kontribuar / që rezulton / që lind / që lidhet në mënyrë direkte ose indirekte me një sëmundje ngjitëse ose frikën ose kërcënimin (qoftë aktuale ose e perceptuar) e një sëmundje ngjitëse pavarësisht nga ndonjë shkak ose ngjarje tjetër që kontribuon njëkohësisht ose në ndonjë sekuencë tjetër të saj.

Përkufizim

Sëmundje ngjitëse - nënkupton çdo sëmundje që mund të transmetohet me anë të çfarëdolloj substance dhe/ose agjenti nga çdo organizëm në një organizëm tjetër, ku:

1. substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet në, një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose çdo variant të tyre, pavarësisht nëse konsiderohet i gjallë ose jo, dhe
2. metoda e transmetimit, qoftë direkte ose indirekte, përfshin, por nuk kufizohet në, transmetimin nëpërmjet: ajrit, lëngjeve trupore, ose transmetimin në dhe/ose nëpërmjet çdo sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngët ose gaz ose ndërmjet organizmave, dhe
3. sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose mirëqënien e njeriut ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin/ përkeqësimin / humbjen e vlerës/ tregtueshmërinë ose pamundësinë e përdorimit të pronës.

Siguruesi / Insurer:

I Siguruari /Insured:

INTERSIG Vienna Insurance Group